

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. GURALI BRAHIMLLARI

06/21/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 18.06.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 21.06.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Gurali Brahimllari, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Roland Ilia, znj. Brunilda Bektoshi relatores, znj. Genta Tafa (Bungo) anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.